



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001748/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për garantimin e të drejtës për testim të qytetarëve për COVID-19. Informim dhe transparencë lidhur me sasitë e tamponëve, kapacitetin për të testuar si dhe liberalizimin e testeve.*

Drejtuar: **Zj.Ogerta MANASTIRLIU**

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANE

E nderuar zonja ministre,

Institucioni i Avokatit të Popullit është duke monitoruar me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet shqiptare për përballimin me sukses të pandemisë së Covid 19. Gjatë këtyre javëve kemi nisur dhe adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, disa problematika të qënësishme të bëra publike në media nga profesionistë të sistemit shëndetësor, intelektualë e akademikë lidhur me rritjen e numrit të testeve si mjeti më efikas për përballimin e kësaj situatë me sa më pak pasoja, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare mbi strategjinë dhe vendimarrjen për testimin aktual të pacientëve të dyshuar me Covid 19 dhe më tej të qytetarëve në tërësi.

E gjithë kjo situatë e krijuar tashmë në gjithë globin na bind akoma më shumë se mbajtja në një nivel të lartë dhe cilësor të shërbimit shëndetësor publik të një vendi, si dhe investimi në kërkimin shkencor në shëndetësi, luajnë një rol përcaktues në përballimin e situatave të tilla me emergjencë të lartë shëndetësore.

Të vetëdijshëm për situatën e vështirë në të cilën gjendet vendi ynë, ashtu sikundër edhe shumë vende të tjera të botës, si edhe duke mirëkuptuar vështirësitë me të cilat ballafaqohen autoritetet shqiptare në zbatim të planit të

masave për të mundësuar identifikimin dhe ndjekjen e hetimit epidemiologjik të shtetasve të lidhur me pacientin e diagnostikuar pozitiv me Covid-19, vërejmë se numri i testeve të diagnostifikimit megjithërritjen që ka pësuar ai prej muajit Maj 2020, mbetet i vogël në raport me me vendet fqinje si Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali Zi etj.

Mbrojtja e shëndetit dhe e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë e mbrojtur jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në Republikën e Shqipërisë, por edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat vendi ynë ka aderuar, të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Sociale Evropiane, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në kuadër të aplikimit të Biologjisë dhe Mjekësisë, etj.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë Neni 15 dhe 55/1 parashikojnë se :

- 1) *Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.*
- 2) *Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.*
- 3) *Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.*
- 4)

Ligji nr.10138, dt.11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, neni 1 Qëllimi i Ligjit:

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetesës së shëndetshme të popullatës në Republikën e Shqipërisë, përmes veprimeve të organizuara, ndikimi i të cilave shpërndahehet, në mënyrë të barabartë, në të gjitha grupet e popullatës.

Neni 28 Parandalimi dhe Kontrolli i Sëmundjeve infektive:

Parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive përfshin mbikëqyrjen epidemiologjike të këtyre sëmundjeve e të faktorëve të rrezikut, si dhe tërësinë e masave, që synojnë parandalimin e zhvillimit të agjentëve infektivë, minimizimin e shfaqjes ndaj infeksioneve, reduktimin e ndjeshmërisë së individëve dhe të popullatës ndaj sëmundjeve infektive, parandalimin e zhvillimit të shenjave biologjike e klinike të këtyre sëmundjeve, diagnozën e hershme dhe trajtimin e bazuar në evidencë të sëmundjeve infektive dhe parandalimin apo minimizimin e ndërlikimeve nga këto sëmundje.¹

Gjithashtu edhe Ligji Nr. 15/2016 “Për Parandalimin dhe luftimin edhe sëmundjeve infektive”, Neni 4; përcakton parimet për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive si më poshtë:

¹ Gjithashtu përgjegjësitë e shtetit dhe individëve janë të specifikuara edhe në nenet 6, 46 e ne vijim të ligjit nr.10138, dt.11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”

- a) parandalimi i sëmundjeve ngjitëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshëm; b) parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet pa asnjë lloj diskriminimi;
- b) mbrojtja nga sëmundjet infektive bëhet sipas një planifikimi, programimi, organizimi, zbatimi të masave për parandalimin, diagnozën, trajtimin, luftimin, zhdukjen e sëmundjeve infektive dhe sigurimin e mjeteve e infrastrukturës së domosdoshme për mbrojtjen shëndetësore ndaj tyre;
- c) çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;
- d) çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;
- e) çdo personi të dyshuar ose të konfirmuar me sëmundje infektive, sipas një liste të përcaktuar nga Shërbimi Kombëtar i Inteligjencës Epidemike dhe Shërbimi Kombëtar i Kujdesit ndaj Sëmundjeve Infektive, të miratuar me urdhër nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, i ofrohet shërbim shëndetësor i menjëhershëm dhe falas, pavarësisht nivelit të kujdesit shëndetësor;

Më tej neni 8 përcakton mekanizmat për zbulimin në kohë të burimeve të infeksionit dhe rrugëve të përhapjes së tij: **dh) kryerjen e testimit vullnetar, për ekzaminimet e mësipërme, në grupe të popullatës; e) hulumtimin dhe ekzaminimin epidemiologjik, hulumtimin mikrobiologjik dhe kontrollin shëndetësor të personave që vuajnë, ose dyshohen se vuajnë nga sëmundjet infektive, shkaktari i të cilave nuk është i njohur.**

Edhe Karta për të drejtat e Pacientit detajon të drejtat e pacientëve në lidhje me shërbimin mjekësor në funksion të parandalimit të sëmundjeve infektive. Më konkretisht kjo kartë përcakton: *Të Drejta për Masat Parandaluese*: “Çdo pacient ka të drejtën e një shërbimi të duhur me qëllim parandalimin e sëmundjeve. Shërbimet shëndetësore kanë për detyrë ndërgjegjësimin e njerëzve, duke garantuar procedurat shëndetësore në intervale të rregullta kohore, falas për grupe popullatash në rrezik, ku rezultatet e kërkimeve shkencore dhe novacioneve teknologjike të jenë të vlefshme për të gjithë.”

E drejta për Shërbim të Sigurt sanksionohet më tej në këtë kartë e cila parashtron se: “Çdo pacient ka të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dëmtimet dhe rreziqet shkaktuar nga mos funksionimi i duhur i shërbimeve shëndetësore, kequshtrimi të profesionit mjekësor dhe gabimeve, dhe të drejtën për të pasur një shërbim dhe trajtim shëndetësor që plotëson standarde të larta sigurie.

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në kuaër të aplikimit të Biologjisë dhe Mjekësisë sanksionon se shtetet në përputhje me nevojat shëndetësore dhe burimet që kanë në dispozicion duhet të marrin masat e nevojshme brenda juridiksionit të tyre për të siguruar akses të barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor të cilësisë së duhur (neni 3)².

² <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168007cf98>

Me aktin normativ nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, qeveria shqiptare ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe kufizimin e të drejtave të garantuara nga nenet 37, 38, 41, pika 4, 49 deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.

Zbatimi i këtij akti normativ u zbatua j opa sfida, veçanërisht në raport me informimin dhe transparencën e publikut të gjerë lidhur me numrin e testeve, mundësinë reale dhe kapacitetin që ka shteti për kryerjen e tyre, sasi të e porositura, shpalosjen e strategjisë se përse ky testim nuk shtrihet në masë të gjerë etj. Megjithë përmirësimin e situatës , mendojmë se ende transparenca mbetet një sfidë për përballimin e kësaj situatë.

Sjellim në vëmendje se transparenca dhe informimi i publikut lidhur me kapacitetet e shtetit shqiptar për të kryer testimin e popullsisë, si dhe me arsyet e moskryerjes së testeve është tepër e rëndësishme dhe e lidhur ngushtë me cilësinë e menaxhimit të situatës së epidemisë, si edhe me besimin e qytetarëve tek autoritetet shtetërore.

Sipas udhëzimeve të nxjerra nga OBSH në lidhje me komunikimin gjatë situatës së epidemisë³, ekzistojnë dy aspekte të ndërlidhura të transparencës gjatë një epidemie. Njëra i referohet cilësisë së komunikimit mbi informacionin që nevojitet nga njerëzit dhe komunitetet gjatë një emergjence në mënyrë që të shmangin sëmundjet dhe të ndalojnë përhapjen e saj. Aspekti i dytë i transparencës synon të promovojë besimin midis autoriteteve të shëndetit publik dhe publikut. Një nga rekomandimet kryesore të OBSH gjatë periudhës së pandemisë është transparenca. Arsyeja e parë dhe më e ngutshme për transparencën gjatë një emergjence shëndetësore është roli që luan informacioni në promovimin e objektivave themelore të shëndetit publik. Kur publiku rrezikon nga një kërcënim i vërtetë ose i mundshëm për shëndetin, mundësitë e trajtimit mund të jenë të kufizuara, ndërhyrjet direkte mund të kërkojnë kohë për t'u organizuar dhe burimet mund të jenë të pakta. Prandaj, komunikimi i këshillave dhe udhëzimeve shpesh qëndron si mjeti më i rëndësishëm në dispozicion për administrimin e një rreziku. Përveç shërbimit të objektivave themelore të shëndetit publik, komunikimi publik transparent gjithashtu adreson edhe imperativat kryesore strategjike - politike, ekonomike dhe psikosociale - të cilat janë të lidhura me shfaqjen e shëndetit publik.

Sa i përket numrit të testeve Organizata Botërore e Shëndetësisë në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se vendet duhet të testojnë çdo rast të dyshuar të COVID-19. Nëse njerëzit testohen pozitivisht, ata duhet të izoloohen dhe njerëzit me të cilët kanë qenë në kontakt të ngushtë deri në 2 ditë para se të shfaqnin simptoma, dhe ata njerëz duhet të testohen gjithashtu nëse tregojnë simptoma të COVID-19. OBSH këshillon gjithashtu që të gjitha rastet e konfirmuara, madje edhe rastet e buta, duhet të izoloohen në ambientet shëndetësore, për të parandaluar transmetimin dhe siguruar një kujdes të duhur⁴.

³ <https://www.who.int/ihr/elibrary/WHOOutbreakCommsPlanngGuide.pdf?ua=1>

⁴ <https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19--16-march-2020>

OBSH⁵ alerton shtetet që krahas të gjitha masave të marra mbetet kritike për të testuar të gjitha rastet e dyshuara të COVID-19 kudo që të jetë e mundur, dhe u drejtohet atyre me thirrje menjëherë të izoloni rastet, të gjurmoni kontaktet në masën më të gjerë të mundshme, dhe të siguroni karantinë të kontakteve për kohëzgjatjen e periudhës së inkubacionit. Kjo vlen për çdo kontekst ose nivel të përhapjes së pandemisë në një vend, në mënyrë që të thellohen përfitimet e masave sociale. Masat sociale duhet të bëjnë që detyra e kontaktit të gjurmohet shumë më lehtë pasi numri i kontakteve zvogëlohet me shpejtësi dhe përfundimisht numri i çështjeve zvogëlohet gjithashtu.

Me heqjen e masave sociale, është thelbësore që të vazhdohet të forcohet identifikimi i rasteve, izolimi për rastet e COVID-19 dhe karantina e kontakteve, në mënyrë që t'i përgjigjet rasteve të rigjallëruara ose të importuara. Riorganizimi i koordinuar i shërbimeve shëndetësore dhe sociale është thelbësore për të vlerësuar dhe testuar me shpejtësi personat, për të trajtuar pacientët në mënyrë efektive dhe për të mbrojtur spitalet dhe personelin shëndetësor.

Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, së bashku me OBSH rekomandojnë diagnozën COVID-19 me anë të testeve molekulare të cilat zbulojnë ARN-in e virusit SARS-CoV-2. Kjo është përgjithësisht strategjia aktuale e provës në Shtetet Anëtare⁶.

Sipas rekomandimeve të BE-së⁷, testimi laboratorik me kohë dhe i saktë COVID-19 është një pjesë thelbësore e menaxhimit të COVID-19 për ngadalësimin e pandemisë, mbështetjen e vendimeve për strategjitë e kontrollit të infeksionit dhe menaxhimin e pacientëve në institucionet e kujdesit shëndetësor, dhe zbulimin e rasteve asimptomatike që mund të përhapet virusi më tej nëse nuk izolohet. Strategjitë e fuqishme të testimit kanë treguar se janë një mjet i rëndësishëm në ngadalësimin e epidemisë, mbështetjen e vendimeve për strategjitë e kontrollit të infeksionit në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe përmirësimin e njohurive të aspekteve virologjike të COVID-19. Testimi lejon trajtimin e pacientëve në mënyrë më efikase, duke siguruar gjithashtu informacione për monitorimin e situatës epidemiologjike dhe rritjen e provave të disponueshme për të hartuar masa më të mira të përmbajtjes dhe lehtësimit. Testimi gjithashtu ndihmon në zbulimin e rasteve asimptomatike që mund të përhapin më tej virusin nëse nuk izolohet. Ndërsa evolucioni i situatës epidemiologjike, strategjitë e testimit duhet të përshtaten në mënyrë që të sigurojnë një përdorim optimal të burimeve dhe të lehtësojnë presionin në laboratorë. Prioritet duhet t'i jepet investimit në kërkime dhe zhvillim për diagnostikimin e kujdesit të pikave dhe testet serologjike në udhëzimet për testimin.

⁵ https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/situation-reports/20200401-sitrep-72-covid-19.pdf?sfvrsn=3dd8971b_2

⁶ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/Overview-rapid-test-situation-for-COVID-19-diagnosis-EU-EEA.pdf>

⁷ https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/covid19_-_eu_recommendations_on_testing_strategies_v2.pdf

lidhur me të drejtat e njeriut gjatë kohës së pandemisë⁸ ku thekson disa nga parimet kryesore të të drejtave të njeriut që duhet të mbahen në vëmendje gjatë kohës së pandemisë, të tilla si barazia e aksesit në kujdesin shëndetësor, e drejta e të dhënave personale dhe informimit, etj dhe bën thirrje për veprime të koordinuara dhe që adresojnë sfidat më të mëdha etike.

Për sa më lart, duke marrë shkas nga prononcimet zyrtare se testimet kryhen jo në masë sepse janë sugjeruar nga specialistë, vlerësojmë se kjo nuk mund të shmangë përgjegjësinë e shtetit për shtrirjen masive të testeve qoftë edhe me kosto shtesë nga vetë pacientët por edhe nëse nuk mundet dhe nuk ka sasinë e mjaftueshme të testeve dhe reagentëve për ta bërë një gjë të tillë, t'a liberalizojë këtë procedurë konform akteve dhe direktivave të OBSH-së duke lejuar operatorë të tjerë shëndetësorë qofshin edhe privatë që qytetarët që kanë mundësi ekonomike të mund ta kryejnë vetë këtë procedurë.

Një qasje e tillë, pra respektimi i të drejtave të pacientit i përcaktuar specifikisht në aktet ndërkombëtare dhe të brendshme rekomandohet fuqimisht edhe nga organizmat kryesore të të drejtave të njeriut, e më konkretisht si në deklaratën e Komisioneres së Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut znj. Michelle Bachelet,⁹ Komisioneres për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës znj. Dunja Mijatović¹⁰ dhe një grupi ekspertësh të Kombeve të Bashkuara¹¹, i rekomandojnë autoriteteve shtetërore të shteteve të ndryshme, që në masat që do ndërmarrin për përballimin e pandemisë, të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të njeriut.

Institucioni ynë vlerëson dhe rekoamandon se shteti shqiptar duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme, për t'u siguruar që asnjë shtetasi shqiptar, që dëshiron të bëjë testin e Covid 19 mos t'i mohohet e drejta për t'a kryer, por të gjenden rrugët dhe zgjidhjet alternative për t'a kryer atë. Testimi i popullsisë nuk mund të jetë luks, por një e drejtë për tu kryer në situatën e pandemisë që po kalojmë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

⁸ <https://rm.coe.int/inf-2020-2-statement-covid19-e/16809e2785>

⁹ <https://www.unhcr.org/news/latest/2020/3/5e69eea54/coronavirus-outbreak-test-systems-values-humanity.html>

¹⁰ <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/we-must-respect-human-rights-and-stand-united-against-the-coronavirus-pandemic>

¹¹ <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25722>

REKOMANDON:

- **Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e mundësive për shtrirjen masive dhe kryerjen e testeve të qytetarëve për COVID-19, sygjëruar dhe këshilluar nga OBSH-ja dhe aktet ligjore në fuqi.**
- **Informim dhe transparencë lidhur me sasitë e tamponëve testues dhe kapacitetin për të testuar.**
- **Liberalizimin e testeve në masë të popullsisë si një e drejtë e individit për ruajtjen e shëndetit të tij.**
- **Bërjen të mundur të kryerjes së testeve edhe nga institucione të tjera shëndetësore, të certifikuar në përputhje me ligjin.**

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merren për zbatimin e tij, lutem të na vini në dijeni brenda afateve më të mira.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA